




RAPORT
MBI AUDITIMIN E EKSTRAKTIT
TË III-TË DHE TË IV-T
TË PËRBËRËSVE ZGJEDHORË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4
Tiranë, Shqipëri

ELENA XHINA

Audit Teknikien

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

I nderuar z.Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Në zbatim të vendimit nr. 208, datë 23.11.2022, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për emërimin e auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si dhe duke ndjekur udhëzimin nr.2, datë 28.12.2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGJC”, ju sjellim si më poshtë raportin e auditimit të kryer për periudhën 22.11.2022– 30.12.2022.

Në këtë raport jepen vlerësimet dhe rekomandimet për veprimet e kryera mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke analizuar ekstraktin e I-rë dhe të II-të të përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) në zbatim të “Kodit Zgjedhor”, ligjit “Për Gjendjen Civile”, si dhe akteve nënligjore të mëposhtme:

- o Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.207, datë 28.10.2022 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”;
- o Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”;
- o Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.370, datë 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Baza ligjore e auditimit	4
Metodologjia e Auditimit	5
Opinione	6
Rekomandime.....	8
Statistika	9
Përfundime	12

Hyrje

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas dekretit nr.13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, do të zhvillohen më datë 14 maj 2023. Pas krijimit të përvojës nga zgjedhjet e datës 30 qeshor 2019 për organet e qeverisjes vendore, të bazuara mbi ndarjen e re Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore, këto zgjedhje pritet të jenë më të konsoliduara dhe me problematikë më të ulët përsa i përket informacionit të gjeneruar nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Baza ligjore e auditimit

- Ligji nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Vendimi i KM nr.365, datë 11.06.2004 “Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik”;
- Vendimi i KM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.207, datë 28.10.2022 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”;
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë denimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”;
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.370, datë 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.
- Udhëzimit të KQZ-së nr.2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditet tekniciene për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)”.

Metodologjia e Auditimit

Përgjegjësia e audituesit është që të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në “Kodin Zgjedhor”, ligjin për “Gjendjen Civile”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre nga KQZ-ja dhe Ministri i Brendshëm, mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, nga fillimi i procesit deri në shpalljen e listave përfundimtare të zgjedhësve.

Listat e zgjedhësve janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me Kodin Zgjedhor. Auditimi për përbërësit zgjedhorë në kuptimin që ka dhënë Kodi Zgjedhor në nenin 45 nënkupton auditimin për përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

- a) emri;
- b) atësia;
- c) amësia;
- d) mbiemri;
- e) datëlindja;
- f) numri personal i identifikimit;
- g) shtetësia;
- h) kodi i vendbanimit;
- i) gjinia.

Auditimi është kryer mbi parimin e prezumimit të vërtetësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nëpërmjet:

1. Informacioni zyrtar publik nga Ekstrakti i Tretë i Përbërësve Zgjedhorë (21 janar 2023) dhe Ekstrakti i Katërt i Përbërësve Zgjedhorë (19 shkurt 2023)
2. Gjithashtu, nga punonjës të DPGJC është mundësuar aksesimi me të drejta leximi (Vieë) në RKGJC, me qëllim realizimin e auditit.
3. Për realizimin e kërkesave të këtij auditimi janë kryer verifikime/testime të bazuara në kontrollet mbi ekstraktet përkatës si dhe RKGJC, duke filtruar fushat/rekordet përkatës në bazë të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Verifikimi i dublimeve, që në fazat e para të auditit janë vënë në dispozicion nga punonjësit e DPGJC. Sipas tyre testimi është realizuar mbi bazën e krahasimit dhe të ngjashmërisë së rubrikave të përbërësve zgjedhore sipas aneksit nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.370, datë 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.

Opinione

- Janë zbatuar përgjithësisht procedurat në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.207, datë 28.10.2022 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”, të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” dhe të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.370, datë 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.
- Janë gjeneruar brenda afateve ligjore në respekt të pikave 5 dhe 7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor, ekstrakti i tretë dhe i katërt i përbërësve zgjedhore:
 - ekstrakti i tretë i përbërësve zgjedhorë u gjenerua më datë 21 janar 2023;
 - ekstrakti i katërt i përbërësve zgjedhorë u gjenerua më datë 19 shkurt 2023;
- Në zbatim të përcaktimeve të pikës ç), të nenit 48 të Kodit Zgjedhor: është publikuar lista e zgjedhësve online në linkun:
https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12416 ,
i cili mund të gjendet në portalin *e-albania*, në faqen zyrtare të KQZ, si dhe në faqen zyrtare të MB.
Shërbimi elektronik “**Kërkimi i qendrës së votimit (QV)**” i mundëson çdo shtetasi shqiptar të kërkojë adresën e qendrës së votimit në të cilën është caktuar të votojë. *Të dhënat e përdoruesve*

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

shfaqen automatikisht nga databaza e Gjendjes Civile, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Në asnjë rast e-Albania nuk modifikon të dhënat e publikuara.

Informacioni për listat e zgjedhjeve	Ekstrakti I-rë 22.11.2022 2	Ekstrakti II-të 19.12.2022	Ekstrakti III-të 21.01.2023	Ekstrakti IV-ërt 19.02.2023
Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit	5,096	5,198	5,193	5,194
Numri i qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhës)	104	22	1	1
Numri i qendrave të votimit nën limitin (15 - 300 zgjedhës)	3	3	3	6
Numri i qendrave nga 1 deri në 15 zgjedhës	276	30	5	1
Lista e shtetasve 100 vjeç të papërfshirë nga lista	3,845	3,827	3,795	3,779
Lista e shtetasve (dekriminalizimi) të papërfshirë nga lista	754	750	752	805
Lista zgjedhësve me numër banimi 000/888/999	5,365	1,367	648	590
Numri i zgjedhësve në total të përfshirë në lista	3,545,091	3,633,662	3,653,563	3,651,512
Të papërfshirë në lista (për shkak të qendrave jashtë limitit)	115,514	25,218	2,738	2,476
Numri total i zgjedhësve	3,660,605	3,658,880	3,656,301	3,653,988
Meshkuj	1,848,733	1,847,803	1,846,469	1,845,198
Femra	1,811,872	1,811,077	1,809,832	1,808,790

- Ka patur një përmirësim nga ekstrakti i parë deri në ekstraktin e katërt:
 Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit nga 5,096 qv në 5,194 qv;
 Numri i qendrave të votimit mbi limit (1000 zgjedhës) nga 104 qv në 1 qv;
 Numri i qendrave të votimit me 1 deri në 15 zgjedhës nga 276 qv në 1 qv;
 Lista e shtetasve 100 vjeç të pa përfshirë nga lista nga 3,845 në 3,779;
 Lista e shtetasve (dekriminalizimi) të papërfshirë në lista nga 754 në 805;
 Lista zgjedhësve me numër banimi 000/888/999 nga 5,365 në 590;
 Numri i zgjedhësve në total të përfshirë në lista nga 3,545,091 në 3,651,512;
 Numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista (qv jashtë limitit) nga 115,514 në 2,476.

Rekomandime

Bazuar në auditimin e kryer për ekstraktin e tretë dhe të katërt të përbërësve zgjedhorë rekomandoj që:

1. Në mënyrë që mos të ketë më qendra votimi me numër zgjedhësish jashtë kriterëve ligjore sugjeroj që të kryhen ndryshime në sistemin informatik qendror të DPGJC në mënyrë që punonjësit e zyrave të gjendjes civile të mos mundën që një zgjedhësi t'i vendosin një numër QV-je e cila është:

- Jashtë përcaktimeve ligjore
- Nuk është aktive (pa votues)
- Ka numër të ndryshëm nga udhëzimet në fuqi për përcaktimin e numrit të QV-së për rastet specifike (psh.8899 ose 7788),

Gjithashtu rekomandohet që po në sistem të kryhen ndryshime për të detyruar që:

- **Nëse ndryshon një nga fushat “adresa” apo “FamilyID”, do të duhet të konfirmohet edhe numri i QV-së.**

2. Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi me zyrat e Gjendjes Civile dhe njërive të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.

3. Të vijojë puna për verifikimin dhe zbatimin e procedurës së pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit e mbetur, që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.

4. Për reflektimin dhe përmirësimin e numrit të shtetasve të pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, do të duhet një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Statistika

Në bazë të ekstraktit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të përbërësve zgjedhorë të gjeneruara përkatësisht në datat 22 nëntor 2022, 19 dhjetor 2022, 21 janar 2023 dhe 19 shkurt 2023 kemi të dhënat si më poshtë vijon:

1. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në lista

Është bërë kontrolli duke gjeneruar nga RKGJC listën për të gjithë ata shtetas të cilët janë zgjedhës sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ligji nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në ekstraktin e datës 22 nëntor 2022 rezultuan gjithsej 3,660,605 zgjedhës, nga të cilët rezultuan 1,848,733 zgjedhës meshkuj dhe 1,811,872 zgjedhës femra;
- Në ekstraktin e datës 19 dhjetor 2022 rezultuan gjithsej 3,658,880 zgjedhës, nga të cilët rezultuan 1,847,803 zgjedhës meshkuj dhe 1,811,077 zgjedhës femra;
- Në ekstraktin e datës 21 janar 2023 rezultuan gjithsej 3,656,301 zgjedhës, nga të cilët rezultuan 1,846,469 zgjedhës meshkuj dhe 1,809,832 zgjedhës femra;
- Në ekstraktin e datës 19 shkurt 2023 rezultuan gjithsej 3,653,988 zgjedhës, nga të cilët rezultuan 1,845,198 zgjedhës meshkuj dhe 1,808,790 zgjedhës femra.

Nga krahasimi i ekstraktit të katërt me ekstraktin e parë vihet re një diferencë (ulje e numrit) prej **6,617** e numrit total të zgjedhësve, e cila vjen si pasojë e reflektimit të numrit të vdekjeve gjatë periudhës midis ekstraktit të dytë dhe të parë, nga reflektimet e prapambetura që janë në vazhdim, si dhe nga verifikimi i dublimeve.

Ju bëjmë me dije se në asnjë nga ekstraktet zgjedhore të gjeneruara deri më tani nuk është shkelur asnjë nga pikat e nenit 51 të Kodit Zgjedhor. Në të gjitha zyrat e gjendjes civile janë printuar listat e zgjedhësve të ekstrakteve zgjedhore në përputhje me nenin 51, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, për arsye të praktikave dhe procedurave të brendshme të ZGJC-ve, janë gjeneruar statistikat të QV-ve që janë mbi dhe nën limit si dhe më të dhënat e zgjedhësve në këto QV, me qëllim

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

informimin e kryetarëve të bashkive, për të vijuar me nxjerrjen e vendimeve për ndarje/bashkim të qendrave të votimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrat e Gjendjes Civile dhe njësisë të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.

2. Numri i qendrave të votimit (QV)

Nga kontrolli dhe verifikimi i ekstraktit të tretë dhe të katërt, përkatësisht të datës 21 janar 2023 dhe 19 shkurt 2023 rezulton se:

- Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit me numër zgjedhësish brenda përcaktimeve ligjore në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është : 5,193 qendra votimi dhe
- Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit me numër zgjedhësish brenda përcaktimeve ligjore në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është : 5,194 qendra votimi.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 1 qv dhe
- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 1 qv.

Zyrat e Gjendjes Civile duhet të shpërndajnë zgjedhësit në qendra votimi.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 15-300 në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 3 qv dhe
- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 15-300 në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 6 qv.

Ka rritje të numrit të qendrave të votimit me numër zgjedhësish 15-300.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 15 në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 5 qv dhe
- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 15 në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 1 qv.

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

Zyrat e Gjendjes Civile duhet të shpërndajnë zgjedhësit në qendra votimi.

- Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 3,795 zgjedhës dhe
- Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 3,779 zgjedhës.

Nga ekstrakti i parë në ekstraktin e katërt vihet re një ulje e numrit të këtyre shtetasve me 66 zgjedhës, si pasojë e kërkesave që kanë bërë këta zgjedhës për t'u përfshirë në listat e votimit dhe verifikimeve përkatëse të kryera nga Zyrat e Gjendjes Civile. Nga ana e saj DPGJC ka gjeneruar raporte mujore me të dhënat e personave mbi 100 vjeç të cilat u janë dërguar zyrave përkatëse të Gjendjes Civile me qëllim që në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore të kryhet procesi i njoftimit dhe verifikimit të këtyre personave.

Zyrat e Gjendjes Civile kanë realizuar verifikime, bazuar në raportin e DPGJC, por mbetet një numër i konsiderueshëm për shkak të familjarëve emigrant .

- Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000, 888 dhe 999 në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 648 zgjedhës dhe
- Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000, 888 dhe 999 në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 590 zgjedhës.

Lidhur me numrin e zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar, ka patur një bashkëpunim dhe koordinim të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore për të mos patur këtë kategori zgjedhësish, duke ulur numrin e zgjedhësve për këtë kategori nga ekstrakti i parë në ekstraktin e katërt me 4,775 zgjedhës.

- Numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 rezulton: 2,738 zgjedhës dhe
- Numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 rezulton: 2,476 zgjedhës.

Sqaroj se për numrin e zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit, ka patur një bashkëpunim dhe koordinim shumë të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore për të mos patur këtë kategori zgjedhësish, duke ulur numrin e zgjedhësve për këtë kategori, nga ekstrakti i parë deri në ekstraktin e katërt, me 113,038 zgjedhës.

3. Numri i zgjedhësve të papërfshirë nga lista për shkak të dekriminalizimit

Në këtë kategori bëjnë pjesë ata zgjedhës të cilët janë pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.

- Nga kontrolli dhe verifikimi rezulton se numri i shtetasve të papërfshirë nga lista (dekriminalizimi) në ekstraktin e tretë të datës 21 janar 2023 është: 752 zgjedhës dhe
- numri i shtetasve të papërfshirë nga lista (dekriminalizimi) në ekstraktin e katërt të datës 19 shkurt 2023 është: 805 zgjedhës.

Për reflektimin dhe përmirësimin e numrit të këtyre shtetasve do të duhet të vijohet me një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Përfundime

Auditimi për përbërësit zgjedhorë në kuptimin që ka dhënë Kodi Zgjedhor, në nenin 45 nënkupton auditimin për përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

- a) emri;
- b) atësia;
- c) amësia;
- d) mbiemri;
- e) datëlindja;
- f) numri personal i identifikimit;
- g) shtetësia;
- h) kodi i vendbanimit;

i) gjinia.

- Në ekstraktin e datës 21 janar 2023 rezultuan gjithsej 3,656,301 zgjedhës, nga të cilët 1,846,469 zgjedhës meshkuj dhe 1,809,832 zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës 19 shkurt 2023 rezultuan gjithsej 3,653,988 zgjedhës, nga të cilët 1,845,198 zgjedhës meshkuj dhe 1,808,790 zgjedhës femra.

Nga krahasimi i ekstraktit të parë dhe të katërt vihet re një diferencë (ulje e numrit) prej **6,617** e numrit total të zgjedhësve, e cila vjen si pasojë e reflektimit të numrit të vdekjeve gjatë periudhës midis dy ekstrakteve, nga reflektimet e prapambetura që janë në vazhdim, si dhe nga verifikimi i dublimeve.

Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi me zyrat e Gjendjes Civile dhe njësisve të qeverisjes vendore në favor të procesit të verifikimit dhe më pas pastrimit të numrit potencial të dublimeve nga lista e rekordeve të dyshuar si të dubluar.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 është ulur ndjeshëm, nga 104 qv në ekstraktin e parë në 1 qv në ekstraktin e katërt.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 15-300 është rritur dhe kërkohet një bashkëpunim më i madh me Zyrat e Gjendjes Civile.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 15 është ulur nga 276 qv në 1 qv. Duhet të eliminohen gabimet njerëzore të nëpunësve të ZGJC gjatë përpilimit të dokumentacionit për transferimin e shtetasve nga një zyrë e gjendjes civile në një tjetër, për arsye të ndryshimit të vendbanimit.

Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista është ulur me 66 zgjedhës, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile po punojnë për kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Raporti i Auditit teknikien për ekstraktin e tretë dhe të katërt

Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000, 888 dhe 999 është ulur duke mbetur 590 zgjedhës. Kërkohe bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore për të mos patur këtë kategori zgjedhësish.

Numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit është ulur në 2,476 zgjedhës, por nëpunësit e zyrave të gjendjes civile duhet të vijojnë me verifikimet, në mënyrë që të mos ketë zgjedhës të papërfshirë në lista për shkak të qendrave jashtë limitit.

Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 15, është ulur ndjeshëm nga 276 qv në ekstraktin e parë në 1 qv në ekstraktin e katërt.

Në ekstraktet zgjedhore të gjeneruara deri më tani (ekstrakti i tretë dhe i katërt) nuk është shkelur asnjë nga pikat e nenit 51, të Kodit Zgjedhor.

Në të gjitha zyrat e gjendjes civile janë printuar listat e zgjedhësve të ekstrakteve zgjedhore në përputhje me nenin 51, të Kodit Zgjedhor.

Janë zbatuar përgjithësisht procedurat në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.207, datë 28.10.2022 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”, të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.370, datë 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.